

AKT - THEMELIMI

I

SHOQERISE TREGETARE "AI GROUP SPACE" Sh. p. k.

Ne baze te ligjit nr.9901, date 14.04.2009 " Per tregtaret dhe shoqerite trgetare " dhe atij nr.9723, date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit " , me vullnetin e tyre te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij Akti, sot me date 06-12-2021,themeluesit Genci Tepelena, lindur ne Vlore me 27-07-1970, banues ne Rrugen "Murat Terbac" - " Pall 53, H. 15 Ap40 9405 -Vlore

Dario Franzoni i datelindjes 17-02-1973 lindur ne Vimercate (MI) - Itali dhe banues ne via G. Matteotti 12 Gessate (MI) - Itali deklarojne se kane vendosur te nenshkruajne kete Akt Themelimi per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "AI GROUP SPACE " shpk aktivitetit i shoqerise do te rregullohet nga Akti i Themelimit, Statuti dhe ligjislacioni shqiptar per shoqerite tregtare.

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar "AI GROUP SPACE " shpk me themelues z Genci Tepelena, dhe Daria Franzoni

NENI 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesvet te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne Rrugen "Fadil Rada " pall 3 kati pare , nr 10, Njesia nr 2 Tirane (Prapa ish ATSH) Ajo mund te çele dhe seli te tjera te treta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjenci operative ne te gjithë territorin e R.SH, dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

NENI 5

Objekti i veprimtarise do te jete :

- Studio projektimi dhe inxhinierike per industrine e lehte dhe ushqimore turistike, si dhe makineri ambalazhuese dhe mbushese per industrine kozmetike, agroalimentare mjekesore dhe farmaceutike.
- Import-eksport tregtim me shumice dhe pakice mallrave te ndryshme te cdo lloji, te produkteve plastike, te materialeve dhe paisjeve elektrike, metaleve e prodhimeve metalike ,te mallrave ushqimore e blegtoarele te llojeve te ndryshme.
- Lende te para dhe asesore te ndryshem per prodhimin e shitjen e produkteve kozmetike etj.
- Prodhimin dhe shitjen e integrorve ushqimor, dhe produkteve agroalimentare.
- Projektim, studim, realizim, konsulence ndermjetesim, per zhvillim biznesi, per projekte informatike dhe multimediale, ose me inteligjence artificiale dhe per automatizim procesesh dhe internazionalizimin e bizneseve.
- Projektim realizim, konstruktim, administrim, rikonvertim, mirmbajtje, konsulence shitblerje te impianteve te prodhimit te energjise elektrike sidomos ne fushen e energjive te rinovueshme si hidroelektrike, fotovoltaike, eolike, mobilitet elektrik dhe te gjitha aktiviteteteve te lidhura me kto.
- Projektim studim konsulence dhe punime te ndryshme speciale per konstruksion e instalim ne fushen industriale, turistike, agroalimentare si dhe per furnitura speciale.

- Instalime mirmbajtje dhe riparime e impianteve elektrike, elektronike, idrosanitare e termosanitare elektrike me gas si dhe sisteme te rinovueshme.
- Punime ndertimi gjenerale dhe infrastrukture germime dhe levizje toke.
- Organizim dhe konsulence dhe sherbime per kerkime tekniko shkencore dhe studime per shfrytezimin e burimeve te energjive te rinovueshme dhe burimeve termike me qellim prodhimin e energjise se paster me burime te asimilueshme me energjite e rinovueshme.
- Blerje direkte ose me kontrate shfrytezimi per shoqerite qe kane koncesione hidrocentrale centrale dhe impiante prodhimi dhe shperndarje te energjise elektrike per mirmbajtjen dhe administrimin e tyre.
- Studime dhe realizime te infrastruktures dhe mjeteve te transportit ne fushen e mobilitetit elektrik dhe konvertimin e mjeteve ekzistuese ne mjete elektrike dhe ibride si dhe furnitura speciale per transportin elektrik dhe shperndarje energjie... etj.
- Projektim studim realizim konsulence per zhvillim biznesi per projekte informatike multimediale smart ose me inteligjence artificiale per automatizim procesesh.

Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje objektin e veprimtarise se saj ,si dhe munde te marre persiper perfaqesime,te hape dhe te ngrej filjale ne te gjithe vendin.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise per behet ne te holla me nje vlere prej100.000 lek (njqindmije) Kapitali eshte i ndare ne 2 kuota. Nje kuote eshte 66.000 leke dhe i perkete z.Dario Franzoni, kuta tjeter eshte 34.000 leke dhe i perkete z. Genci Tepelena

Sipas kontributeve ne kapitalin themeltar te shoqerise 66 perqind zoterohet nga z. Dario Franzoni dhe diferenca prej 34 perqind z Genci Tepelena.

NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakeve, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortakët mund të u shesin të treta kuotat e kapitalit pjesërisht ose tërësisht të parashikuara nga të ligjit nr.9901, datë 14.04.2009 " Për tregtarët dhe shoqëritë tërëtare dhe nga statuti i shoqërisë.

NENI 9

Shoqëria ka vullen e saj me përmbajtje " AI GROUP SPACE " shpk Tirane, Albania.

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë :

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

Fusha e veprimt, përberja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet në statut.

NENI 11

Administrator të shoqërisë " AI GROUP SPACE " shpk " do të jenë z. Genci Tepelena dhe z. Çezar Goga

NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në baze të kritereve të caktuara nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria ka llogarive e saj rrjedhese, si dhe librin e saj të llogarive në baze të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e të dispozitave të tjera fiskale.

NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim të ortakëve të saj duke u shpërndarë në raport me kontributin e secilit në kapital , mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet e të jetë hequr fondi i rezervës ligjore.

NENI 14

Akti u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte sejcila, per t' u depozituar ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

O R T A K E T

Genci TEPELENA



Dario FRANZONI

